

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ DEGA NË SHTËRPCË**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarës J.Gj. nga fshati ....., komuna e Shtërpcës, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 par.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokuroris Themeore në Ferizaj PP/II.nr.2318-7/15 e dt.05.01.2016 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të dt.25.08.2015, në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Veton Shabani dhe të akuzuarës J.Gj. si dhe të dëmtuarit ....., të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

E akuzuara J.Gj. nga fshati ....., komuna e Shtërpcës, data e lindjes....., nga i ati D. dhe e ëma B., e gjinisë B., serbe, shtetase e Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, e martuar, nënë e katër fëmijëve, e pa punë, amvise, e gjendjes së varfër ekonomike, e pa dënuar deri më tani, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTORË**

Sespe me dt.16.11.2015 rreth orës 12:30 në Shtërpcë përkatësisht në shtëpinë e tyre pas një fjalosje mes të

pandehurës-bashkëshortja e të dëmtuarit, e pandehura fillimisht e sulmon fizikisht të dëmtuarin, derisa i dëmtuari arrin që të delë nga dhoma e shtëpisë ngase e pandehura merrë 3 thika në duar nga kuzhina dhe niset në drejtim të dëmtuarit i cili veç kishte arritur ti bllokoj derën me këmbë, e pandehura në vazhdimësi ka kanosur me fjalë të ndryshme kërcënuese të dëmtuarin derisa arrin policia në vend ngjarje, e pandehura largon thikat nga duart posa vëren policinë, ashtu që këto fjalë të i dëmtuari kanë shkaktuar shqetësim dhe frikë për jetë.

Me këtë ka kryer veprën penale kanosja nga neni 185 par.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës të sipërcituar dhe neneve 4, 17, 49, 50, 51, 52, dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarën e

## **G J Y K O N**

Të akuzuarës **J.Gj.** i vërtetohet dënimi me burg prej 4 / katër / muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

I dëmtuari ..... nga fshati ....., komuna e Shtërpcës, nuk i është bashkangjitur ndekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasuroro-juridike kundër të akuzuarës, andaj gjykata nuk e ka udhëzuar në kontest civil.

E akuzuara obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.2318-7/15 e dt.05.01.2016 me të cilën ka ngarkuar të akuzuarën J.Gj. nga fshati ....., komuna e Shtërpcës, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 par.4 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së me dt.25.08.2016, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Veton Shabani, e akuzuara J.Gj. dhe i dëmtuari .....

Në fillim të shqyrtimit fillestar e akuzuara është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPRK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drerjtat e të akuzuarës janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën që i vehet në barrë dhe pasë leximit prokurori i shteti ka bër kualifikimin e veprës penale dhe atë kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së në paragrafin 4 të të njëjtit nen pasi janë bashkëshortë palët në këtë çështje penale.

Më pas gjyqtari është bindur se i njëjta e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtës i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e saj lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

E akuzuara J.Gj. në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtores dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe krejt kjo ka ardhur për shkak të gjendje jo të mirë ekonomike dhe pa pritur është nervozuar, i kërkon falje bashkëshortit, është penduar menjëher dhe nga ky rast më nuk ka përsëritur veprime të tilla duke premtuar se edhe në të ardhmen nuk do të përsëris, i kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merrë për bazë si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë si dhe atë se është nënë e katër fëmijëve.

I dëmtuari .....,në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se të akuzurën e ka bashkëshorte dhe nga kanosja në fjalë më nuk i ka përsëritur ato veprime por edhe menjëherë pasi e ka bërë kanosjen e njëjta është penduar, andaj për këto ka kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta liroj nga përgjegjësia penale e gjithashtu nuk ka parashtruar as kërkesë pasuroro-juridike.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është e bindur se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarës gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë,mbrojtësit dhe të dëmtuarit

Prokurori i shtetit Veton Shabani ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se e akuzuara pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe atë edhe në deklaratën e të dëmtuarit dhënë në polici me dt.16.11.2015 dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarës manifestohen të gjitha elementet e veprës penale kanosja nga neni 185 par.4 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarën mori pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtës, me qka ka treguar sinqeritet në procedurën penale, është penduar për veprën e kryer, i kërkon falje të dëmtuarit-bashkëshortit të saj, është nënë e katër fëmijëve dhe e pa punë, dhe mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me burg prej 4 / katër / muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarës dhe me te arrihet

qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që e akuzuara të mos kryej vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 461 par.1të KPPRK-së gjykata të dëmtuarin ..... nga fshati ....., komuna e Shtërpcës, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike nuk e ka udhëzuar në kontest civil pasi i njëjti është tërhequr nga një kërkesë e tillë në shqyrtimin fillestar.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPRK-së është obliguar të akuzuaren që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË  
SHTËRPCË  
P nr.17/2016 me datë 25.08.2016**

**Asistenti**

**Gjyqtari**

Muedin Rexhepi

Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet  
ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate